



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR BUJQËSI , PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Reference: 12-320

Datë:	05.11.2016
Për:	z.Imri AHMETI - Kryetar i Komunës së Lipjanit
Nga:	Feti KRASNIQI -Drejtore i Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural
Lënda:	Plani i aktiviteteve për muajin Tetor : 2016

Shtojcë: Plani i aktiviteteve të Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural për muajin Tetor të vitit **2016**

DBPZHR ne Lipjan gjatë muajit Tetor. 2016 , ka planifikuar planin e punes dhe ka zhvilluar keto aktivitete :

Përparimi i përgjithshëm i bujqësisë, si degë e cila ka kuptimin strategjik të komunës përmes:

- Përkrahje prodhuesve të rinj, teknologjisë bashkohore, profesionalizmit, iniciativave të zhvillimit afatgjatë në territorin e Komunës së Lipjanit.
- Programeve për përparimin e lavërtarisë, pemëtarisë, vreshtarisë dhe perimekulturës përmes zhvillimit të sistemit të këshillimeve bujqësore .
- Krijimit të kushteve për qasje në tregun e pemëve dhe perimeve përmes qendrave distribuove në tregun mobil në Prishtinë.

Aktivitetet profesionale : Tetor 2016

- Takimet javore në Bordin e Drejtorëve
- Takimet me stafin lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë në punë (Rastet në sektorin e pylltarisë , lista e vijueshmërisë , plani i shfrytëzimit sa me racional te buxhetit).
- Ka vazhduar Përforcimi i shërbimeve këshillimore të organizuara nga MBPZHR.
- Avancimi i Qendres informative per shërbime këshillimore bujqesore.

- Nga Inspektorati pyjor i Kosoves , kemi pranuar nje Vendim , per ndalimin e gjuetise ne tere territorin e Komunes se Lipjanit , dhe rekomandimet per te inicuar procedurat ligjore per dhenjen ne menagjim te zones gjuetise se perbashket Lipjani.

- Lidhur me vendimin , ne kemi ftuar ne takim shoqatat e gjuetise ne Lipjan , dhe i kemi informuar per procedurat e vendimit.

- DBPZHR-ka pranuar kërkesa ,lidhur me daljen ne teren per vlerësim te demeve nga dukuri të ndryshme.Komisioni ka dalë në vendshikim dhe ka hartuar proces verbalet perkatese.

- DBPZHR, ka mbajtur takim pune me Udheheqjen e SHKK, në Lipjan , me qellim që bashkarisht të hartohet nje planë i aftesimeve profesionale per grupmoshat e ndryshme te cilat jane ne vujtje te denimeve ne shtepine korrektuese ne Lipjan.Procesi i bashkëpunimit vazhdonë.

- Gjate këtij muaji ka vazhduar mbjellja e grurit vjeshtor sipas planit operativ dhe kushtet klimatike kan qenë mjaft të favorshme. Mundemi me konstatue qe te gjitha sipërfaqet e planifikuar per mbjellje me grurë janë realizuar.

- Gjatë tetorit kemi pranuar mjaft kërkesa nga banoret e vendbanimeve dhe institucioneve , lidhur me shqetësimet e tyre qe kanë nga prezenca e madhe e qeneve endacak neper vende te ndryshme , afer shkollave , afer marketeve , dhe ne veçanti afer pikave grumbulluese ku hudhen mbeturinat. Ne disa prej ketyre rasteve jemi munduar qe aq sa na lejone ligji tu dalim ne përkrahje banoreve.

Jane vlerësuar deme ne sipërfaqet pyjore.

Janë regjistruar dhe përgatitë fletëparaqitje për Gjykata dhe prokurori si raste te prerjeve ilegale te pyjeve.

Gjatë këtij muaji fermeret jane njoftuar me vendimet e MBPZHR , lidhur me pagesat direkte per sipërfaqe (pjesa e dytë e pagesave direkte) ende nuk janë publikuar listat perfundimtare ne kete qeshtje.

Ne disa raste jane kërkuar dokumente plotësuese per disa fermer , ne ju kemi ndihmuar ne plotësimin ligjor te tyre.

Ka vazhduar damkimi i pyjeve private.

Po ashtu jane vazhduar punet rutinore administrative.

DBPZHR-në Lipjan gjatë muajit tetor 2016 , ka raportuar ne mbledhjen e KPF-së , dhe mbledhjen e asamblesë komunale , lidhur me përgatitjet per mbjellje 2016/2017